



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202300965/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave për pagesën e kësteve të dëmshpërblimit, znj.A.G, trashëgimtares së të dënuarit politik P.J.G*

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
Znj. Risena XHAJA

Tiranë

E nderuar zonja Xhaja,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ashtu sikurse jeni në dijeni nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm për trajtimin e rasteve të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, në datën 30.10.2023 është regjistruar ankesa e shtetases A.G.

Kjo shtetase ka paraqitur në ankesën e saj se është trashëgimtare e ish të dënuarit politik, P.J.G, me nr.dosje ****, datë 09.04.2008 miratuar me VKM nr.497, datë 01.08.2012 me masë dëmshpërblimi përfundimtar 2 102 000 lekë.

Prej vitit 2012 e deri më sot ankuesja pretendon se ka marrë vetëm një këst dëmshpërblimi, si dhe shprehet se ka paraqitur të gjitha dokumentet që i janë kërkuar.

Për të bërë të mundur ndjekjen e këtij rasti, kemi kërkuar informacion në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet shkresës nr. K2/A38-2, datë 16.11.2023.

Me shkresën nr.21796 prot., datë datë 30.11.2023 Ministria e Financave dhe Ekonomisë referon si më poshtë vijon:

“Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për shpërndarjen e dëmshpërblimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në mënyrë proporcionale deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.

*Në lidhje me kërkesën tuaj për dosjen e z.P.G, me nr.****, miratuar me VKM nr.1147, datë 25.11.2009 me vlerë përfundimtare 1.816.110 lekë, ju informojmë se trashëgimtarët ligjorë të z.G kanë përfutur këstin e parë të dëmshpërblimit financiar më datë 19.05.2014, shumë e cila është kredituar në llogarinë bankare të znj.A.G, e cila është trashëgimtare dhe person i autorizuar me prokurë nga përfutuesit e tjerë të dosjes.*

Më datë 04.12.2017, shqyrtimi juridik i dosjes është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për kësht të dytë.

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, i cili parashikon se:

“Brenda një afati 3 mujor nga data e publikimit të listës, të gjithë ish të përndjekurit/trashëgimtarët, të cilët janë pjesë e saj, duhet të dorëzojnë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dokumentet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, i jepet një afat shtesë deri në 30 ditë. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet edhe pas kalimit të afatit shtesë (30 ditë), pagesa i kalon personave që kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshëm për pagesë.”

Pas maturimit të afatit ligjor të sipërcituar, trashëgimtarët e dosjes nuk kanë plotësuar dokumentacionin ligjor të kërkuar dhe për rrjedhojë dosja nuk është procesuar për këstin e dytë.

*Në datë 04.04.2022, shqyrtimi juridik i dosjes nr.**** me numër pagese 341 është publikuar në faqen zyrtare për këstin e tretë dhe pas maturimit të afatit ligjor të sipërcituar, në dosje vijon të mungojë dokumentacioni ligjor, si më poshtë vijon:*

-Vërtetimi i llogarisë bankare i përditësuar të hapur në njërin prej bankave të nivelit të dytë që operon në territorin e Republikës së Shqipërisë, në monedhën lek, për trashëgimtarët: A.G (së fundmi kanë dorëzuar vërtetimin e llogarisë bankare të muajit tetor 2021).

Aktualisht, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve ka çelur këstin e katërt për kategorinë joparësore (trashëgimtarë) dhe po proceson për pagesë dosjet deri në listë pagesën 100.”

Në përmbushje të mandatit të tij kushtetues, Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar në misionin e tij të mbrojtjes, garantimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

Pa dyshim, vëmendje të veçantë kanë marrë të drejtat e ish të dënuarve/përndjekurve politikë apo të të afërmeve/trashëgimtarëve të tyre që vijojnë të vuajnë pasojat e rënda të ish-regjimit diktatorial.

Gjatë periudhës rreth gjysmë shekullore regjimi diktatorial në Shqipëri ekzekutoi, internoi dhe burgosi, për arsye politike, dhjetëra mijëra shqiptarë në burgjet dhe kampet e internimit në të gjithë vendin. Persekutimi komunist ishte më i përhapur në vendet e vuajtjes së dënimit, në burgje dhe në kampet e internimit, ku të ndëshkuarit vuajtën nga torturat më të rënda, në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të ligjit ndërkombëtar humanitar.

Pavarësisht se kanë kaluar tashmë **33 vjet** nga shembja e sistemit komunist në Shqipëri, shoqëria shqiptare është ende e ndjeshme ndaj kësaj periudhe të errët në historinë e saj. Po ashtu, sipas parashikimeve të ligjit nr.7514, datë 30.09.1991, i ndryshuar, *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë duhet të kishte përfunduar vite më parë, por për fat të keq, kjo shtresë vijon të mbetet e marginalizuar dhe problem thelbësor i shoqërisë shqiptare.

Në ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 *“Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”* përcaktohet detyrimi ligjor dhe moral i shtetit për zbatimin e ligjit e të drejtën për kompensim. Por edhe pse ky ligj fillimisht parashikonte se procesi i kompensimit do të plotësohej në fund të vitit 1994, vetëm në vitin 2007 u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, në zbatim të të cilit janë nxjerrë edhe aktet nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të sistemit komunist.

Përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohë optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme. Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar shpeshherë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësimit të detyrimit të shoqërisë shqiptare për finalizimin e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit dhe trashëgimtarët e tyre. Masat për dëmshpërblimin material përbëjnë veprime të cilat shpesh kuptohen në mënyrë jo të qartë.

Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por nuk është përcaktuar as një afat apo datë e saktë se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar e të tejzgjatur rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, nuk është e mjaftueshme vetëm njohja e të drejtave për këtë kategori, por ato duhet të realizohen efektivisht nga shteti, brenda afateve të arsyeshme dhe jo të mbeten thjesht deklarative.

Ritheksojmë se është thelbësore përshpejtimi i dhënies së kësteve të dëmshpërblimeve për shtresën e ish të dënuarve/përndjekurve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, duke vënë në vend të drejtat e shkelura dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre.

Ky proces tashmë 33 vjeçar po e bën të paarrtshme këtë të drejtë, përse një pjesë e mirë e personave që kanë vuajtur në atë regjim po moshohen e rrjedha e ciklit të jetës është e paevitueshme.

Procesi i planifikimit të kësteve të dëmshpërblimit ndër vite duhet të kish qenë i tillë që procesi të kishte përfunduar, por ende edhe sot mbetet e paqartë se kur do të përfundojë.

Nga rasti i trajtuar i znj.A.G dhe ankuesve të tjerë në institucionin e Avokatit të Popullit, janë evidentuar burokraci të njëpasnjëshme dhe të tepërta për ridepozitime të vazhdueshme të fotokopjeve të dokumenteve të identitetit ose pasaportave dhe të vërtetimeve bankare, që në thelb nuk e ndihmojnë procesin.

Çmujmë se është domosdoshmëri ndërgjegjësimi dhe rritja e përgjegjësisë së strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rishikimin e dokumentacionit të depozituar nga përfituesit dhe njoftimin në kohë reale të tyre. Znj.A.G prej vitit 2014 e deri më tani, **pas gati 10 vitesh, ka përfituar vetëm një këst dëmshpërblimi.**

Sa më sipër, vlerësohet e paarsyeshme, nisur nga fakti se ankuesja nuk ka mungesa në dokumentacion, por i kërkohet vetëm ridepozitim i vërtetimit të llogarisë bankare. Avokati i Popullit vlerëson se roli i administratës për plotësimin e këtyre detyrimeve jo vetëm ligjore, por edhe morale të shoqërisë tonë duhet të jetë proaktiv.

Strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk mund të justifikohen pas paragrafit të dytë të nenit 14 të ligjit ku parashikohet:

“Brenda një afati 3 mujor nga data e publikimit të listës, të gjithë ish të përndjekurit/trashëgimtarë, të cilët janë pjesë e saj, duhet të dorëzojnë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dokumentat e parashikuara në paragrafin e mësipërm, i jepet një afat shtesë deri në 30 ditë. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet edhe pas kalimit të afatit shtesë (30 ditë), pagesa i kalon personave që kanë dorëzuar dokumentat e duhura dhe janë të gatshëm për pagesë.”

Gjykojmë se ky paragraf duhet të shihet i lidhur në mënyrë të pashkëputur e në vijimësi të detyrimit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni ku përcaktohet se:

“Struktura përgjegjëse për pagesën e dëmshpërblimeve të ish të dënuarve politikë në Ministrinë e Financave publikon, në mënyrë periodike, në faqen zyrtare, listat e dosjeve të gatshme për pagesë dhe bën njoftimin për të gjitha subjektet përfituese, pjesë e listës, nëpërmjet shërbimit postar, njoftimit me mjete të komunikimit elektronik (e-mail) dhe medias publike.”

Në asnjë rast të trajtuar nga ana jonë e për të cilat është ngritur shqetësim në strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga ana e këtyre të fundit nuk na është përcjellë informacion që përfituesit të jenë njoftuar prej tyre në çdonjërin nga mënyrat e parashikuara me ligj, të cituara më lart. Është e qartë se afati 3 mujor është një afat që nis pas njoftimit të përfituesit të së drejtës në një nga mënyrat e treguara në nenin 14, paragrafi i parë.

Sjellim edhe njëherë në vëmendjen tuaj se gjatë trajtimit të këtyre rasteve, duhet vlerësuar me ndjeshmëri situata dhe vështirësitë me të cilat përballen këta njerëz në moshë tepër të thyer.

Mendojmë se nuk duhet humbur dëshira e mirë institucionale për të zbatuar dispozitat ligjore në mënyrën më objektive dhe efektive të mundshme në favor të qytetarëve.

Së fundmi, Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e bëra dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por shpreh dëshirën dhe nevojën për rritjen dhe përmirësimin e tij në të ardhmen, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të adresuara.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të menjëhershme për pagesën e kësteve të dëmshpërblimit, znj.A.G, trashëgimtares së të dënuarit politik P.J.G, duke shmangur vonesat e pajustificuara për ridërgime dhe ripërsëritje të dokumenteve që janë depozituar së fundmi.

- Marrjen e masave nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e detyrimit ligjor të njoftimit të përfitueses, sipas parashikimit në paragrafin e parë të nenit 14 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëshmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi